

**D E K R E T**  
**Nr.831, datë 24.4.1994**

**PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.7463, DATË 30.1.1991 “PËR POLICINË FINANCIARE”**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7791, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

**D E K R E T O J:**

**Neni 1**

Në nenin 1 të dekretit nr.7463, datë 31.1.1991 “Për Policinë Financiare”, fjalët “... me seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë...”, zëvendësohen me fjalët “... me seli brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

**Neni 2**

Në nenin 2 fjalët “... dhe jep llogari edhe përpara këshillave popullorë të rretheve dhe rajoneve”, zëvendësohet me fjalët “... dhe bashkëpunon me organet e pushtetit lokal”.

**Neni 3**

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

- Përpara shkronjës “a” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Policia Financiare ka këto detyra:”

- Shkronja “a” e nenit 3 ndryshohet si vijon:

“Të ushtrojë kontroll për dokumentimin dhe regjistrimin e saktë të shpenzimeve, të të ardhurave dhe të rezultatit financiar të veprimtarisë që kryejnë personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj me seli brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë e që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për pagimin e plotë e në afatet e caktuara të detyrimeve që rrjedhin nga sistemi fiskal në Republikën e Shqipërisë”.

- Shkronja “b” e nenit 3 ndryshohet si vijon:

“Të ushtrojë kontroll për dokumentimin e zbatimin e çmimeve dhe tarifave të caktuara, të rregullave të peshimit, ruajtjes, standardeve dhe të cilësisë në prodhim, ndërtim e shërbime për mënjanimin e përfitimeve të paligjshme dhe të evazionit fiskal”.

- Shkronja “c” e nenit 3 ndryshohet si vijon:

“Të kontrollojë sistematikisht dhe të zbulojë ushtrimin e veprimtarisë ekonomike pa leje, blerjen për shitje dhe të çdo veprimtarie tjetër shitblerjeje të mallrave dhe të kryerjes së shërbimeve pa leje me qëllim fitimi, si dhe të marrë masa për ndalimin e tyre”.

**Neni 4**

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

- Në shkronjën “a” të nenit 4 hiqen fjalët “... e kooperativa”, kurse fjalët “... me seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, zëvendësohen me fjalët “... me seli brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

- Shkronja “b” e nenit 4 ndryshohet si vijon:

“Të hyjë, me miratimin e prokurorit, në banesa e objekte kur ka të dhëna për ushtrimin e veprimtarive ekonomike të kundërligjshme. Për shkeljet e vërejtura të mbajë procesverbal dhe të sigurojë prova të mjaftueshme për sanksionet sipas shkeljes së konstatuar”.

- Në shkronjën “ç” të nenit 4 fjala “... kontrollime...” të zëvendësohet me fjalën “... kalzime...”.

## Neni 5

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Veç rasteve të parashikuara me dispozita të veçanta, janë kundërvajtje administrative që dënohen nga organet e Policisë Financiare.”.

- Në shkronjën “a” të nenit 5, fjala “private”, zëvendësohet me fjalën “ekonomike”.

- Në shkronjën “b” të nenit 5, fjalët “... veprimet që bëhen...”, ndryshohen me fjalët “... veprimet dhe mosveprimet që bëhen...”.

- Shkronja “h” e nenit 5 ndryshohet si vijon:

“Mospajisja e blerësve me dokumentin e shitjes së mallit”.

- Pas shkronjës “h” shtohet shkronja “i” me këtë përmbajtje:

“Mosdokumentimi i qarkullimit dhe ruajtjes së mallrave në të gjitha hallkat e veprimtarisë ekonomike”.

- Paragrafi i dytë i nenit 5 ndryshohet si vijon:

“Shkeljet e mësipërme kur nuk përbëjnë veprë penale, dënohen nga punonjësit e Policisë Financiare me gjobë nga 2.000 deri në 500.000 lekë me sekuestrimin e mjeteve të punës, të lëndëve të para, të materialeve dhe të produktit të gatshëm, të të ardhurave të siguruara në mënyrë të paligjshme si dhe me heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit apo të veprimtarisë”.

- Pas paragrafit të dytë të nenit 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për vjeljen e detyrimit sipas vendimit të dënimit me gjobë, drejtori i Policisë Financiare dhe kryetari i degës së Policisë Financiare në rreth, nxjerrin urdhër bllokimi për llogaritë rrjedhëse të subjekteve të proceduara. Urdhër bllokimi është i detyrueshëm për organet bankare deri në marrjen e vendimit formë të prerë që përbën titull ekzekutiv për organet bankare”.

- Paragrafi i tretë i nenit 5 bëhet paragraf i katërt dhe ndryshohet si vijon:

“Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim ose protestë brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit tek kryetari i degës së Policisë Financiare në rreth ose tek drejtori i Policisë Financiare. Kundër vendimit të dënimit të këtyre organeve mund të bëhet ankim ose protestë brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja”.

- Paragrafi i katërt i nenit 5 bëhet paragraf i pestë dhe fjalët “... të barabartë me vlerën e gjobës së vënë”, zëvendësohen me fjalët “... të barabartë me detyrimin sipas sanksionit të vënë”. Në këtë paragraf shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Është i pavlefshëm çdo veprim juridik tjetërsimi pasuror që kryen subjekti pas fillimit të kontrollit të organit të Policisë Financiare deri në përfundimin e procedurave për vjeljen e detyrimit”.

## Neni 6

Në nenin 7, fjalët “Policia Financiare ka uniformë...”, zëvendësohen me fjalët “Punonjësit e Policisë Financiare kanë dokumentin e identifikimit, uniformat...”.

## Neni 7

Në nenin 8 fjalët “Policia Financiare veprimtarinë e saj e mbështet në dekretin nr.7449, datë 5.1.1991 “Për përdorimin e armëve të zjarrit...”, zëvendësohen me fjalët “Policia Financiare veprimtarinë e saj e mbështet edhe në dispozitat ligjore për përdorimin e armëve...”.

## Neni 8

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**KUNDËRFIRMOHET**  
**KRYEMINISTRI**  
**Aleksandër Meksi**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**  
  
**Sali Berisha**

